

V E N D I M
Nr.88, datë 10.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 10.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.85 Akti që i përket:

KËRKUES: MERO BAZE, kandidat për deputet i subjektit elektoral “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar me prokurë nga avokat Kreshnik Spahiu.

SUBJEKTE TE INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. GAZMIR BIZHGA, përfaqësuar me deklaram nga avokat Nikolla Kondakçi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.010, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm kërkesi ka parashtruar këto shkaqe:

Nga ana e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.26 e më pas nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk janë marrë në konsideratë ankesat e Komisioneve të Qendrave të Votimit për shkeljet e rënda gjatë procesit zgjedhor. Në qendrën e votimit nr.4, kutia e votimit është mbushur nga policia; në qendrën e votimit nr.8, anëtarët e komisionit kanë pajisur një person me disa fletë votimi; në qendrën e votimit nr.14, një votues votoi për gjithë familjen; në qendrat e votimit nr.3, 6, 7, 11, 11/1, 12, 71, 78 dhe 78/1, procesverbalet janë plotësuar pas dëbimit të komisionerëve të opozitës; në qendrat e votimit nr.66/1, 72 e 77, Komisioni i Zonës Zgjedhore nuk ka emëruar tre nënkryetarë të këtyre komisioneve; në qendrën e votimit nr.71, komisionerët e pozitës kanë ndikuar në mënyrë të hapur tek zgjedhësit; në procesin e numërimit të votave, komisionerët e opozitës janë nxjerrë jashtë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.010, datë 30.6.2001 ka vendosur të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.26, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Gazmir Bizhga.

Kërkesi Mero Baze ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pretenduar një sërë shkeljesh, të tilla si: nuk janë emëruar nënkryetarët e komisioneve në disa qendra votimi; në qendrën e votimit nr.4 kutia e votimit është mbushur nga policia; në qendrën e votimit nr.8 anëtarët e komisionit kanë pajisur një person me disa fletë votimi; në qendrën e votimit nr.14 një votues votoi për gjithë familjen; në qendrën e votimit 71 komisionerët e pozitës kanë ndikuar në mënyrë të hapur tek zgjedhësit; në disa qendra votimi procesverbalet janë plotësuar pas dëbimit të komisionerëve të opozitës.

Lidhur me pretendimin se Komisioni i Zonës Zgjedhore nuk ka caktuar nënkryetarë në disa qendra votimi Gjykata Kushtetuese vlerëson se kjo është një çështje që i përket periudhës parazgjedhore. Në këtë fazë, çdo pretendim zgjidhet në rrugën e ankimit që parashikon neni 140/1 i Kodit Zgjedhor.

Përsa i përket pretendimit se në qendrat e votimit nr.4 dhe nr.8 janë futur në kutinë e votimit disa fletë votimi nga një votues, rezultoi se kjo parregullsi nuk ka ndikuar në rezultatin e votimit për këto qendra votimi. Konkretisht, pas ndërhyrjes së komisionit, këto fletë votimi nuk janë llogaritur në nxjerrjen e rezultatit. Pas këtyre rasteve votimi ka vazhduar normalisht.

Po kështu, edhe pretendimet se ka patur persona që kanë votuar për gjithë familjen, se janë vjedhur fletë votimi, janë të pabazuara. Në këtë drejtim, në procesverbalet dhe në tabelat e rezultateve të qendrave të votimit nuk janë pasqyruar vërejtje që lidhen me shkeljet e pretenduara. Tabelat e rezultateve dhe procesverbalet janë dokumentet që pasqyrojnë gjithë momentet e procesit të votimit dhe përderisa në to nuk janë pasqyruar shkeljet e mësipërme, atëhere pretendimet e mësipërme nuk mund të merren si të provuara.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuarit Mero Baze duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës; nenit 140 të Kodit Zgjedhor si dhe neneve 26 e 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.